



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeho/Prudato Received/Delivery	31. 05 2023	viti god year	3
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa e Princ Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SK/PH/HQ	4556/2023		1/4



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.700/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari –kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës A.nr.700/2023 të datës 04.05.2023 të parashtruar nga ankuesja, me adresë: Rr " " Mati 1, Komuna e Prishtinës, kundër Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.05.2023, morri këtë:

### V E N D I M

- I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.700/2023 të datës 04.05.2023, të parashtruar nga ankuesja
- II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik në Komunën e Prishtinës.

### A r s y e t i m

Ankuesja, e punësuar në Komunën e Prishtinës, sipas Akt Emërimit me numër AE. Nr. 01-112-769 të datës 17.09.2013, në pozitën "Sekretare në Bibliotekë", në Bibliotekën "Hivzi Sylejmani, në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, më datë 07.03.2023 ka parashtruar kërkesë me numër të protokollit Nr.14-117/01-49799/23 në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës dhe në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit, për caktimin e koeficientit dhe pagës në kategorinë nëpunëse civile e nivelit drejtues bazuar në Akt Emërimit aktual.

Ankuesja, e pakënaqur me mos kthimin e përgjigjes nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, lidhur me kërkesën e datës 07.03.2023 me numër të protokollit Nr. 14-117/01-0049799/23, më datë 04.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 17.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Prishtinës, ndërsa Këshilli me datë 22.05.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesa me numër A.nr.700/2023 e datës 04.05.2023; Akt Emërim me numër AE.Nr.01-112-769 i datës 17.09.2013; Kërkesë me numër 14-117/01-49799/23 e datës 07.03.2023; Formulari për ankesë i datës 07.03.2023; Listë e pagave për muajin shkurt 2023; Dokument identifikimi për S. Sh; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 17.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 24.05.2023; Njoftim me numër 23/13 e datës 21.05.2013; Kërkesë me numër 22/13 e datës 15.05.2013; Organogrami me numër 30/15 i datës 28.10.2015; Listë e pagave për muajin gusht 2005; Diplomë; Vërtetim me numër Nr.049 e datës 23.05.2023; Shkresë e datës 12.05.2023.


Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga ankuesja dhe organi i punësimi dhe ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.700/2023 të datës 04.05.2023 të parashtruar nga ankuesja Selvete Shala, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht Aktin e Emërimit me numër AE. Nr. 01-112-769 të datës 17.09.2013, rezulton se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Sekretare në Bibliotekë" në Bibliotekën "Hivzi Sylejmani" i cili institucion vepron në kuadër të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport në Komunën e Prishtinës, me koeficient të pagës, tetë (8), sipas sistemit të vjetër të pagave.

Ankuesja, me datë 07.03.2023 ka parashtruar kërkesë me numër të protokollit Nr.14-117/01-49799/23 në Njësinë e Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës dhe në Drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit lidhur me caktimin e koeficientit dhe pagës në kategorinë nëpunëse civile e nivelit drejtues bazuar në Akt Emërimin aktual, sepse Komuna e Prishtinës pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, e ka kategorizuar ankuesen në Kategorinë Profesional 1.

Ankuesja, e pakënaqur me mos kthimin e përgjigjes nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, lidhur me kërkesën e datës 07.03.2023 me numër të protokollit Nr. 14-117/01-0049799/23, më datë 04.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor për ndryshimin e kategorizimit nga klasa „Profesional 1” në klasën „Drejtues” sipas Akt emërimit aktual.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenin 2, 3 dhe 4 është përcaktuar se : " ...2.Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... " 3. Nëpunës civil - është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i



përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë. 4. Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, si dhe mbështetur në nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-097 për Biblioteka, ku është përcaktuar se Bibliotekat janë institucione kulturore, arsimore dhe informuese, mbi këtë bazë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se në rastin konkret pozita "Sekretare në Bibliotekë" në Bibliotekën "Hivzi Sylejmani" të cilën pozitë e ushtron ankuesja nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil por e njëjta hyn në kategorinë e nëpunësve të Shërbimit Publik, e që rrjedhimisht ankuesja nuk e ka statusin e nëpunëses civile për t'ju shqyrtuar ankesa në Këshillin e Pavarur për Shërbim Civil të Kosovës .

Lidhur me këtë pjesa e V e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve të Shërbimit Publik, mbi këtë bazë duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe pas konstatimit se ankuesja nuk e ka statusin e Nëpunësit Civil, Kolegji i Këshillit vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.700/2023 të datës 04.05.2021 të parashtruar nga ankuesja Selvete Shala, sepse Këshilli shqyrton dhe merr Vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për punësim në Shërbim Civil.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, thekson se "Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe Nëpunësi Administrativ dhe Mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente", nenin 74 paragrafi 1, i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është përcaktuar se, "Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit" ndërsa paragrafi 3 përcakton se, "Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave. Komisioni i Ankesave krijohet: 3.1. në çdo administratë të institucionit të shërbimit publik; 3.2. në çdo ministri për administratën e njësisë të Shërbimit Publik në kompetencë të administratës shtetërore; dhe 3.3. në çdo komunë për nëpunësit e administratës së njësisë së shërbimit publik në kompetencë të komunës". Andaj në këtë kuptim nëpunësit e Shërbimit Publik fillimisht duhet të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në Gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe nenin 6 paragrafi 1.1 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.700/2023 të datës 04.05.2023 të parashtruar nga ankuesja sepse Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në Shërbim Civil

Çështja e „Jo kompetencës “nga ana e Këshillit, gjegjësisht çështja e statusit të të punësuarave në Bibliotekën "Hivzi Sylejmani " përkatësisht statusi si „Nëpunësi e Shërbimit Publik“ e ankueses për pozitën "Sekretare në Bibliotekë" është vendosur dhe vërtetuar edhe me Aktgjykimin me numër A.nr.1213/21 të datës 10.03.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative.



Marrë parasysh konstatimin si me lartë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 700/2023 të datës 04.05.2023 dhe meqë nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesja nuk e ka shfrytëzuar mjetin e rregullt juridik pranë organit kompetent, Kolegji për Shqyrtim dhe Vendosje të Ankesave duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit të Ankesave për Nëpunësit e Shërbimit Publik në Komunën e Prishtinës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në kuptim të nenit 64 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ku është përcaktuar se " Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës', dhe pas konstatimit se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueses, udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 24 paragrafi 4 ku theksohet se: "Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe Nëpunësi Administrativ dhe Mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në Gjykatën kompetente".

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë Konflikt Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar Vendimi. Inicimi i Konfliktit Administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.700/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankueses
- Komisionit të Ankesave për nëpunësit e Shërbimit Publik në Komunën e Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së

